

ROLI I KISHËS ORTODOKSE SERBE E GREKE NË POLITIKËN ANTISHQIPTARE

Mark Krasniqi

Prishtinë

KUD 949.65:281.5
289.1:949.6
Punim studimor

Marrë për botim më 15 tetor 1993

Përmbajtja e shkurtër: Politika ekspansioniste sllave e greke ndaj popullit shqiptar dhe trojeve të tij etnike dhe historike gjithmonë është përkrahur nga kisha ortodokse e këtyre fqinjëve të popullit shqiptar. Kjo ka bërë që me forcën ushtarake dhe me përkrahjen e miqve të tyre ndërkombëtarë në Kongresin e Berlinit më 1878, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913 dhe në Konferencën e Paqes në Paris më 1919, edhe sot e kësaj dite ka mbetur e pushtuar më se gjysma e trojeve shqiptare dhe më se gjysma e popullit shqiptar nga sllavët dhe grekët fqinj.

Me ndarjen e kishës unike krishtere më 1054 në kishën ortodokse të lindjes dhe në kishën katolike romake të perëndimit, edhe në trojet shqiptare u bë kjo ndarje, sipas ndikimit të fqinjëve tanë grekë e sllavë nga njëra anë, dhe të Romës e Venedikut nga ana tjetër, sidomos përmes Kryepeshkopatës (Arqipeshkvnisë) së Tivarit, të cilën Papa Gregori VII e themeloi më 1077. Por heret në Shqipëri ishte përhapur ortodoksizmi, kështu që në jug deri në lumin e Shkumbinit peshkopatat (ipeshkvënitë) vareshin nga Kryepeshkopata e Ohrit, kurse në veri nga Shkumbini ato ishin nën juridikcionin e mitropolisë ortodokse të Durrësit. Nën juridikcionin e Kryepeshkopatës së Tivarit ishin Ipeshkëvia e Shkodrës, Ulqinit, Drishtit, Shasit dhe e Shurdhahut. Kryepeshkopatat përpiqeshin të vendosin nën pushtetin e tyre sa më shumë peshkopata, kurse peshkopatat luftonin që të rrëmbejnë sa më shumë famulli, sepse kjo sillte të ardhura më të mëdha për hierarkinë kishtare. Selitë qendrore të këtyre dy kishave ishin në lindje Konstantinopoja (Stambolli) dhe në perëndim Roma, me kryepatrikun, përkatësisht papën në krye.¹ Në Kosovë, sido-

mos në pjesën lindore të saj, shqiptarët gjithashtu, në pjesën më të madhe ishin të besimit ortodoks, të lidhur me administratën e Patrikanës së Pejës dhe mbanin antroponimi të përzier shqiptaro-sllave, ose antroponimi fetare ortodokse sllave e më pak bizantine.² Arqipeshkëvia e Tivarit ka pasur territor shumë të gjerë nën juridiksionin e saj - deri në lumin Savë Danub dhe në disa vise të Bullgarisë.³ Kështu pra, edhe Kosova përfshihej në territorin e saj, ku në pjesën perëndimore, përkatësisht në Rarfshin e Dukagjinit, kishte më shumë shqiptarë të besimit katolik.

Ndarja e kishave u bë më tepër me qëllim për të fituar pavarësi e pushtet, sesa nga motivet e mospajtimit ideologjik. Prandaj, me kohë kisha ortodokse, jo vetëm që nuk njohu më papën e Romës, por as Kryepatriku i saj nuk kishte pushtet mbi të. Ai përfaqësonte vetëm bashkimin simbolik të kishës ortodokse, e cila u nda në disa kisha nacionale sipas shteteve ose popujve të këtij konfesionit. Kështu në shekullin XIII u mëvetësua edhe kisha ortodokse serbe, e cila u lidh ngusht me pushtetin shtetëror dhe u bë krah i fortë i politikës së tij. Kishën ortodokse serbe autoqefale e themeloi Sava Nemanjiqi, të cilin kisha e proklamoi të shenjtë. Mirëpo, qysh në fillim kjo kishë tregoi zemërngushtësinë dhe agresivitetin e saj, duke e ndjekur madje edhe lerin ortodoks nëse nuk ishte serb. Vetë shenjti Sava e përzuri peshkopin e Prizrenit që ishte grek dhe në vend të tij e emëroi një serb. Kjo mostolerancë u gjykua nga arqipeshkopi i Ohrit si akt në kundërshtim me moralin kristian.⁴ Por ky ishte vetëm fillimi i praktikës së tillë. Kisha ortodokse, pra, u bë kishë nacionale, kurse kisha katolike nuk e mori këtë rrugë, por mbeti në parime universale, internacionale, duke njohur Papën e Romës për pushtet suprem. Ndërsa kisha ortodokse u bë kishë shtetërore, duke iu nënshtruar politikës shtetërore, kisha katolike mbeti e pavarur, madje duke ardhur shpeshherë në kundërshtim me shtetin., Kisha ortodokse serbe është konsideruar gjithmonë jo vetëm si organizatë fetare, por edhe si organizatë politike, ajo ka qenë dhe është faktor i fuqishëm i bashkimit kombëtar dhe i ngritjes së vetëdijes kombëtare e shtetërore. Ajo u bë faktor i rëndësishëm në përpjekjet e shtetit për unifikimin shpirtëror me popullin serb të të gjithë atyre popujve joserbë të cilët jetonin në përandorinë e car Dushanit të shekullit XIV.⁵ Me fjalë

1 Universiteti Shtetëror i Tiranës, *Historia e popullit shqiptar* I, Prishtinë, 1968, 164, 174.

2 Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekullit XV - XVII*, Tiranë, 1984, 19.

3 Konstantin Jireček, *Istoriya Srba, II*, Beograd, 1952, 73-k.

4 Gjini Gaspër, *Skopska-prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Zagreb, 1986, III.

5 Vasa Kazimirović, *Intelektualni tvorac srpske državne misli*, «Politika», Beograd, 2.II.1993.

të tjera, kisha është vënë në shërbim të politikës zaptuese dhe asimiluese të shtetit ekspansionist serb në trevat e Ballkanit, para së gjithash, në Shqipëri, e cila atëherë ndodhej e okupuar nga car Dushani serb, bashkë me Greqinë dhe një pjesë të Bullgarisë. Kisha ortodokse nuk ka qenë vetëm organizatë fetare e politike, ajo u bë përfaqësues i vërtetë politik i popullit serb.⁶ Këtë politikë e zbatonte shteti serb me dhunë e terror, me pëlqimin dhe bekimin e kishës. Në kodin (kanunin) e car Dushanit përcaktoheshin masa të rrepta ndëshkuese kundër atyre të cilët e përqafojnë «fenë heretike», përkatësisht katolike. Priftërinjtë katolikë persekutoheshin dhe kishat katolike rrëmbeheshin e serbizoheshin, duke u shndërruar në kisha ortodokse.⁷

Asimilimi i shqiptarëve nga ana e kishës dhe shtetit serb bëhej në mënyrë të ndryshme. Përveç dhunës dhe terrorit të hapët, kisha përdorte edhe sakramentet e shenjta për të kryer këtë mision të saj djallzor. Ajo foshnjeve shqiptare u jepte emra sllavë, po kështu vepronte edhe me rastin e kurorëzimit të qifteve të rinj, me imponim që ritet dhe uratat fetare të jenë në gjuhën sllave etj. Nga presioni i tillë i kishës ortodokse serbe shumë familje shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi janë sllavizuar. Në Mal të Zi kështu janë asimiluar edhe fise të tëra shqiptare, siç janë Kuqët, Bjellopavliqët (Palabardhët), Piprrajt, Vasoviqët etj. Atje edhe sot vazhdon procesi i asimilimit, përkatësisht i sllavizimit të shqiptarëve.⁸ Sipas burimeve historike, në Dioklenë (Malit të Zi) e pavarur të shekullit XI e XII, feja katolike ka qenë dominante, derisa dinastia e Nemanjiqëve ia imponoi popullsisë së kësaj treve pushtetin serb dhe fenë ortodokse. Meqenëse shteti dhe feja në mesjetë kanë vepruar së bashku, kanë pasur një kuptim të përbashkët, feja ortodokse mori kuptimin edhe të përkatësisë kombëtare serbe-ata që ishin ortodoksë merreshin se ishin njëkohësisht edhe serbë. Kështu me zgjerimin e shtetit serb, zgjerohej edhe feja ortodokse dhe emri serb⁹. Nga ana tjetër, në Serbi ka pasur aq shumë katolike shqiptarë sa që në raportet e misionarëve, dërguar Papës në shekullin XVII, thuhej se «Thelbin e katolikëve në Serbi e përbëjnë shqiptarët, kështu që atje fenë katolike e quajnë «la fede albanese.»¹⁰ Më 1332 viset e Serbisë së atëherëshme i vizitoi murgu francez Borkard, i cili, në raportin e tij dërguar mbretit të Francës thotë se Rashka (Serbia) është një vend ku katolikët trajtohen me fyerje e me dhunë. Ai i propozon mbretit që ta sulmojë Serbinë se nuk do ta këtë vështirë këtë punë, sepse

6 Enciklopedijski leksikon - *Istorija*, -Beograd 1970, 639.

7 Branislav Djurdjev etj., *Historija naroda Jugoslavije*, II, Zagreb 1959, 108.

8 Milan Shufflay, *Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë, 1968, 29.

9 Po aty.

10 Savo Brković, *O postanku i razvoju crnogorske nacije*, Titograd, 1974, 15.

do të ketë përkrahjen e dy popujve katolikë që jetojnë atje - të «Albanëve dhe Latinëve... Kombet e përmendura, si Latinët ashtu edhe Albanët, shtypen egersisht nga robëria shumë e rëndë dhe e padurueshme e zotërinjve sllavë tepër të urreyer dhe të neveritshëm.» Këtë raport, sipas mendimit të disa historianëve, duket se e ka shkruar kryepeshkopi i Tivarit Guljem Adami, duke theksuar se në këtë luftë kundër Serbisë rolin kryesor do ta luanin feudalët shqiptarë të cilt mund të nxirrnin 15 mijë kalorës, burra të fortë, trima dhe luftëtarë të mirë.»¹¹ Për t'i zhdukur edhe gjurmët e katolicizmit në viset shqiptare, kisha ortodokse serbe kishte marrë në sy sidomos monumentet kulturoro-historike të tyre, pra objektet fetare - kishat dhe manastiret, të cilat i uzurponte me forcë. Kështu sot një numër i madh i kishave të vjetra gjatë bregdetit adriatik, rreth Liqenit të Shkodrës, në Kosovë e në Maqedoni, të cilat dikur ishin katolike, sot janë ortodokse serbe. Madje, gjatë historisë, dhe sot, këto kisha e manastire politika ekspansioniste serbe i merr «si argument historik» për të justifikuar pushtimin e trojeve të huaja, të trojeve shqiptare, para së gjithash në Kosovë. Mirëpo, dihet se serbët kanë filluar të zbresin në Kosovë nga shteti i Rashkës në veri për të parën herë kah fundi i shekullit XII, mbas luftës kundër Bizantit më 1180, kurse këto monumente fetare kanë qenë aty ku janë shumë kohë para ardhjes së serbëve në këto vise, të banuara gjithmonë nga shqiptarët, por të qeverisura nga Bizanti deri më 1180 kur vdiq perandori Komnini i Parë.¹²

Sundimtarët serbë, kryesisht Nemanjiqët, i kanë zgjeruar ose meremetuar disa nga këto manastire të lashta, por nga themeli ata kanë ndërtuar pak sosh. Këtë e thotë edhe historiani i njohur Konstantin Jireçeku, i cili ka shkruar deri tash historinë më të mirë të popullit serb, dhe ka qenë mik i afirmuar i tij. Ai shprehimisht thotë se «Manastirin e Banjskës, mes Rashkës dhe Fushës së Kosovës e kanë rindërtuar (meremetuar M.K.) mbreti Stefan Uroshi II Millutin dhe vëllai i tij Stefan Dragutini. Po ky mbret e ka përtrirë manastirin e Zonjës së Bekuar Graçanicën, në qendrën e peshkopatës së Lipjanit.» Edhe në Maqedoni Nemanjiqët kanë meremetuar shumë manastire të kohës së Bizantit (Nagoriçani në Tetovë, në Gostivar, në Prilep etj.).¹³ Mirëpo, serbët të gjitha manastirët e tilla i konsiderojnë si vepër monumentale kulturore të Nemanjiqëve të mesjetës, duke përvetësuar kështu veprat dhe të drejtat e huaja. Shkencëtari serb, Pero Slijepeviqi këtë e thotë në mënyrë më decisive: «Është vërtetuar se nga numri i madh i shumë manastireve të vjetra serbe, vetëm një numër i vogël i tyre është themeluar me të

11 USHT, *Historia e popullit shqiptar*, I, 191; *Bujku*, Prishtinë, 6.3. 1993.

12 Ivan Božić etj., *Istorija Jugoslavije*, Beograd, 1972, 51.

13 K. Jireček, *Istorija Srba*, II, ..., 69, 72.

vërtetë nga ai serb i cili ka lënë nënshkrimin e tij në atë kishë.... Serbi nuk ka pasur kurrëfarë tradite të vetën as në ndërtimtari, as në piktorim.»¹⁴ Me uzurpimin e kishave katolike gjatë bregdetit, sidomos në Bokë dhe vende të tjera në rajonin më të gjerë të Malit të Zi të sotëm, ortodoksizmi agresiv ka arritur ta zhdukë epërsinë katolike, e cila këtu mbretëronte me parë.¹⁵ Kështu është bërë asimilimi i shqiptarëve në këto treva, por kjo politikë serbo-ortodokse kështu është sjellë edhe ndaj popujve të tjerë. Kisha dhe shkenca serbe ua mohon edhe malazezëve kombësinë e tyre, duke i trajtuar vetëm si fis serb, pjesëtarë të fesë ortodokse shtetërore serbe. Kjo politikë kishtarë-shtetërore vazhdon edhe sot të veprojë.¹⁶

Nga presioni i tillë serbo-ortodoks shumë familje shqiptare qysh nga mesjeta janë detyruar të braktisin trojet shekullore të tyre në Kosovë dhe të strehohen në male të larta të Malësisë, ku edhe për këtë shpërngulje të dhunshme ruhet tradita brez mbas brezi.¹⁷

Me invezionin osman në shekullin XV në trevat tona etnike fillon procesi i ndryshimeve të mëdha jo vetëm politike, ekonomike dhe përgjithësisht shoqërore, por gjithashtu edhe në sferën shpirtërore, përkatësisht fetare. Turqit kishin për qëllim ta asimilojnë popullin shqiptar, dhe këtë mendonin ta realizonin me anë të fesë myslimane, të cilën e përhapnin me dhunë dhe me disa privilegja të natyrës ekonomike, përkatësisht fiskale, kurse shtresa feudale për këtë qëllim dhurohej me privilegje të mëdha.¹⁸ Gjatë pesë shekujve të robërisë osmane përdorshin nga pushteti metoda të ndryshme për islamizimin dhe asimilimin e popullit shqiptar. Turqit madje, e identifikonin përkatësinë fetare me atë kombëtare, etnike, kështu që, sipas tyre, çdo mysliman ishte njëkohësisht edhe turk. Megjithëse pjesa më e madhe e popullit shqiptar kaloi nga krishterimi në fenë muhamedane, prapë ai nuk u asimilua. Shqiptari mysliman mbeti shqiptar, madje kundërshtar i përhershëm i okupatorit turk. Përjashtim kanë bërë disa familje në disa qytete, në një numër të parëndësishëm. Kështu u bë ndarja e dytë fetare e popullit shqiptar me dhunë, e imponuar nga pushtuesi e jo me bindje as besim se njëra fe është më e mirë se tjetra. Madje, shqiptari kurrë nuk ka qenë besimtar i mirë në asnjërën fe. Feja e tij është morali i lartë tradicional e jo dogmat fetare. Përkatësia fetare vetëm në raste të rralla, të nxitura nga i huaji, ka mundur të jetë mollë sherri. Në saje të vetëdijes kombëtare, të lidhjeve fisnore,

14 Pero Slijepčević, *Stare srpske zadužbine*, «Ogledi», Beograd 1934, 97, 115

15 Simo Ćirković, *Istorija Crne Gore, I*, Titograd 1967, 75.

16 Savo Brković, *Etnogenezofobija*, Cetinje 1988, 6, 67.

17 Rrok Zojzi, *Ndarja krahinore e popullit shqiptar, Etnografia shqiptare I*, Tiranë 1962, 35.

18 USHT, *Histori ...*, 342.

familjare, zonale etj. gjithmonë ka dominuar ideali kombëtar mbi përkatësinë fetare. Kjo shihet edhe nga një raport i Benedikt Orsinit, të cilin më 1621 papa e emëron ipeshkv të Lezhës. Ky ipeshkv i kombësisë së huaj, i shkruan Papes se «Priftërinjtë shqiptarë kanë lidhur besë të mos pranojnë asnjë ipeshkv që mos të ishte prej kombit shqiptar.»¹⁹ Shembuj të ngjashëm ka edhe në kuadër të klerit islam dhe ortodoks shqiptar. Për shqiptarin patriarkal ndërrimi i fesë nuk ka qenë ndodhi e rëndësishme, sepse ai kurrë nuk ka pasur bindje dhe njohuri të thellë fetare. Ai më tepër ka besuar në fantazmat mitologjike nga tradita e tij, të trashëguar brez mbas brezi, se në predikimet fetare të klerit të vendit, ose të importuar nga Roma, Atina, Stambolli. Për botëkuptimin e shqiptarit më të kapshme kanë qenë zanat e malit, drangojt, shtrigat dhe lugetërit, se sa shenjtërit dhe engjujt e pejgamerët e ndryshëm të botës së imagjinuar. Madje, edhe vetë klerikët në shumë raste kanë qenë pa njohuri dhe bindje fetare. Raportet e misionarëve të dërguara Kongregacionit të Propagandës së Fesë në Romë, janë dokumente të rëndësishme për njohjen e rrethanave politiko-shoqërore të viseve etnike shqiptare në shekullin XVII. Këtu, në lidhje me gjendjen dhe nivelin profesional të disa klerikëve po përmendim raportin e Arqipeshkvit të Tivarit, Pjetër Mazrekut të vitit 1633, i cili pos tjerash, shkruan se «Në këto male, edhe në qoftë ndonjë prift, është kaq i paditur sa përveç emrit meshtar, nuk ka tjetër.»²⁰ Për një prift tjetër me shërbim në Gjakovë, thuhej se ai as meshën nuk di ta thotë, por përsërit vazhdimisht një uratë latinisht, të cilën e ka mësuar përmendësh duke i mashtruar kështu besimtarët se gjoja po mban meshën. Në nivel edhe më të ulët kanë qenë shumë klerikë myslimanë dhe ortodoksë. Edhe kjo gjendje në klerin shqiptar ka ndikuar në paqëndrueshmërinë e besimtarëve, përkatësisht në ndërrimin e fesë së mëparshme. Prandaj kanë pasur të drejtë rilindësit tanë kur e kanë cilësuar popullin tonë si fetar kombëtar para së gjithash. Në lidhje me këtë po cek fjalët e një kleriku katolik të ditëve tona i cili thotë: «Siç duket, shqiptarët janë ngopur me fe; ata sot disi kalojnë jetën me një «fe» të re, të cilën ua lënë stërnipëve të tyre të ardhëshëm që t'ia japin emrin.»²¹

Kisha ortodkse serbe edhe gjatë sundimit osman në Ballkan vazhdoi punën e saj antishqiptare. E mësuar për të qenë në shërbim të pushtetit shtetëror, ajo u vu me servilitet nën mbrojtjen e sulltanit, nga i cili mori autorizime të mëdha për mbikqyrjen e saj mbi të gjithë të krishterët në

19 USHT, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin XVII*, I, Tiranë 1963, 393.

20 *Po aty*, 447.

21 Gjergj Gjergji - Gashi, *Albanski mučenici u razdoblju 1846-1848*, Zagreb 1988, 22-35.

trevat etnike shqiptare, të cilat dikur ishin të okupuara nga Serbia. Kjo vlente sidomos për Kosovën dhe vise të tjera veriore të Shqipërisë. Nga ana tjetër, pushteti turk e përkrahte kishën serbe në këtë punë duke i rënduar katolikët shqiptarë me taksa të mëdha shtetërore dhe me diskriminim të gjithanshëm. Kështu p.sh. serbët ortodoksë paguanin 40 groshë tatim për familje, kurse shqiptarët katolikë nga 60 groshë, madje këta paguanin edhe taksa të posaçme për të gjithë meshkujt mbi 12 vjeç. Turqit i dënonin shqiptarët katolikë nëse kishin emra të tyre fetarë ose kombëtarë. Kjo shkonte në favor edhe të kishës serbe, për t'i detyruar katolikët të kalojnë në ortodoksizëm. Shumë nga këta merrnin emra myslimanë dhe publikisht paraqiteshin si myslimanë, kurse në shtëpi mbanin zakonet dhe rregullat e fesë së vjetër. Këta janë të ashtuquajtur laramanë ose kriptokatolikë.²²

Arqipeshkvi i Shkupit, Andrej Bogdani i shkruante më 10 gusht 1670 Kongregacioni të Propagandes së Fesë në Romë, duke u ankuar se katolikët shqiptarë më shumë vuajnë nga ortodoksët serbë se sa nga turqit, kështu që ata më në fund do të detyrohen të kalojnë në ortodoksizëm. Patrikut të Pejës çdo vit duhej t'i jipet një shumë e caktuar të hollash, për mos t'i detyruar katolikët me anë të pushtetit turk që të kalojnë në fenë ortodokse.²³ Kisha ortodokse serbe jo vetëm që i detyronte katolikët shqiptarë të ndërronin emrat e tyre dhe të sllavizoheshin, por ajo, bashkë me shtetin serb, sllavizonte edhe toponominë shqiptare, sidomos në ato vise ku i kishte pronat e veta. Ajo «çdo gjë që ka qenë e fesë ortodokse, e ka konsideruar si serbe, edhe emrat e fshatrave duhej patjetër të ishin serbe.»²⁴ Patriarkana e Pejës i ka pasur duart e lira të bëjë ç'të dojë, pa kurrëfarë penegese nga pushteti turk. Patriku i Pejës merrte nga katolikët nga një dukat për kokë, i detyronte të kurorëzoheshin në kishën serbe dhe t'u mirret 5 deri 10 dukat për kurorëzim.²⁵ Për të paguar qëndrimin miqësor të pushtetit turk ndaj kishës ortodokse, serbët kanë marrë pjesë masive në ushtrinë turke më 1551-1552 për pushtimin e viseve jugore të Hungarisë, sidomos të Banatit. 105. Qëndrimi i kishës ortodokse kundër shqiptarëve ka qenë armiqësor edhe në Sanxhakun e Nishit (Toplicë etj.), nga u dëbuan me terror ushtarak me 1877-78 qindra e mijëra shqiptarë nga trojet e tyre shekullore dhe u rrënuan të gjitha xhamitë e falëtoret e tjera.²⁶

22 *Po aty*, 22 - 35.

23 J. Radonić, *Rimska kurija...*, 347.

24 S. Brković, *Etnogenezofobija...*, 147.

25 B. Djurdjev etj. *Historija...*, 105.

26 Sabit Uka, *Shpërngulja e shqiptarëve nga Serbia jugore më 1877-78 dhe vendosja e tyre në rrafshin e Kosovës*, Prishtinë 1991.

Roli i kishës ortodokse serbe në politikën antishqiptare ka qenë shumë i madh në të gjitha periudhat dhe në të gjitha rrethanat që nga shekulli XI e deri më sot. Ky rol i saj ka qenë shumë drastik sidomos gjatë luftërave ballkanike, Luftës së Parë Botërore dhe pas këtyre luftërave, kur ushtria serbo-malazeze bëri gjenocid të paparë kundër popullit shqiptar në Kosovë, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit, më 1913, për t'i detyruar familjet shqiptare të kalojnë në fenë ortodokse dhe të sllavizohen. Më 1913 vetëm në rrethinat e Pejës e të Gjakovës u pushkatuan 4000 banorë e në Plavë e Gusi 800 shqiptarë që refuzuan ta mohojnë fenë e tyre myslimane ose katolike dhe kombësinë e tyre shqiptare.²⁷ Miku i madh i popullit shqiptar, gazetarja dhe publicistja e njohur angleze Mis Edith Durham, ka qenë dëshmitare e gjallë e tragjedisë së popullit shqiptar të atyre viteve. Ajo e para ka lajmëruar botën për krimet e serbo-malazezëve kundër popullit të pafajshëm, të cilit ia kishin djegur shtëpinë dhe ia merrnin edhe kokën në emër të kirishtërit serbo-malazez. T'i dëgjojmë disa fjalë të saj: «Më 1913 serbët kanë therur me bajoneta gratë dhe fëmijët e Lumës.... Myslimanët i kishin vënë të zgjidhnin midis pagëzimit ose vdekjes me pushkatim. Grave ua hiqnin perçet dhe i çonin në kishë të pagëzoheshin bashkë me fëmijët e tyre. «Brenda një brezi ne do ta sllavizojmë këtë popull», thoshin ata. Nuk ka pasur turk që të jetë sjellë me armenët më keq se u sollën dy popuj serbë me shqiptarët në emër të kishës së shenjtë ortodokse.... Nga Gjakova vinin lajmet se Atë Paliqin, një françeskan trim, të cilin e kisha takuar atje në vitin 1908, e kishin vrarë me bajonetë, sepse nuk kishte pranuar të bënte kryq sipas mënyrës ortodokse.... Në Mal të Zi katër batalione malaazezësh vazhdonin të mbillnin përsëri terror. Myslimanëve u ofroheshin dy rrugë: pagëzim ose vdekje... Burrat thershin, ndërsa grave të tyre u hiqeshin perçet apo shamitë dhe pagëzoheshin, bile në disa raste edhe përdhunoheshin.»²⁸ Dëshmitarët e gjallë të kësaj tragjedie kombëtare tregojnë se në këtë masakër merrnin pjesë aktive edhe vet popat serbo-malazez - duke mbajtur në njëren dorë kryqin e në tjetren kuburen e Karadakut. Megjithëkëtë, shqiptarët në Kosovë shekuj me radhë i kanë mbrojtur dhe ruajtur disa kisha të njohura ortodokse të mesjetës, kështu që ato qëndrojnë të paparekura edhe sot e kësaj dite vetëm në saje të kujdesit, të cilin e kanë treguar shqiptarët për to.²⁹ Fshatari i ndërshtëm shqiptar ka menduar se po ruan shtëpinë e

27 Bajram Redžepagić, *Pustinjak*, Sarajevo, 1982, 367, 371.

28 Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për shqiptarët dhe Shqipërinë*, Tiranë 1990, 391, 402.

29 Mark Krasniqi, *Rojtarët e kishave në Kosovë, Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë, 1979, 129.

Perendisë, atij nuk i ka shkuar mendja se ajo është në shërbim të politikës djallëzore antishqiptare.

Kisha ortodokse serbe edhe sot është në shërbim të politikës antishqiptare të ditës. Kjo shihet nga pjesëmarrja e saj në tubime, shkrime dhe paraqitje politike antishqiptare, ku akuzohen shqiptarët për vepra, të cilat kurrë nuk i kanë bërë, për të ngjallur urrejtje sa më të madhe kundër tyre. Ajo identifikohet krejtësisht me pushtetin okupues serb në Kosovë. Madje, ka në programin e saj ndërtimin e shumë kishave në fshatra dhe qytete të Kosovës për t'i serbizuar edhe në këtë mënyrë këto vise. Për këtë qëllim kisha ortodokse ka uzurpuar midis Prishtinës trojet e Universitetit ku ka filluar ndërtimi i kishës më të madhe në Ballkan. Kështu ajo përpiket të bëjë presion në shqiptarët për ta braktisur Kosovën. Këto kisha nuk ndërtohen për nevojë të besimtarëve ortodoksë, as për nderë të Perendisë. Këto kisha ndërtohen për nevojë të politikës antishqiptare, ekspansioniste, shoviniste serbe, për nderë të udhëheqësve të politikës së tillë shkurtpamse.

Nga kjo që u paraqit këtu me këtë rast shihet se kisha ortodokse serbe nuk është kishë nacionale, por nacionaliste, është më parë organizatë politike se institucion fetar, gjithënjë në shërbim të idesë së Serbisë së madhe, në shërbim të politikës imperialiste. Nga ana tjetër, kisha ortodokse serbe ka kontribuar për realizimin e bashkimit shpirtëror të këtij populli, për ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe për mobilizimin e tij rreth idealit të shtetit serb për zgjerimin dhe stabilizimin e tij, pa marrë parasyshë normat e moralit fetar në lidhje me respektimin e të drejtave të huaja.

Edhe kisha ortodokse greke gjithmonë ka qenë në shërbim të politikës antishqiptare të shtetit grek, i cili me të gjitha mjetet ka punuar dhe punon për copëtimin tokësor të Shqipërisë dhe për asimilimin e popullit shqiptar. Kështu, më 1945 qeveria greke, me përkrahjen edhe të kishës ortodokse, me gjenocid të përgjakshëm i dëboi të gjithë shqiptarët myslimanë nga Çamëria, kurse shqiptarët ortodoksë kisha dhe qeveria greke i mbajnë për grekë dhe nuk guxojnë ta perdorin gjuhën amëtare shqipe.³⁰ Dikur, në periudhën e shkurtër të qetësisë të fushatës antishqiptare, kryetari i qeverisë greke, gjenerali Pangalos shkruante: «Teza që është mbajtur gjer më sot se ortodoksët shqiptarë janë grekë, është një mendim krejt i gabuar dhe i shkallmuar prej të gjithëve.... Unë mora masat e duhura dhe shpërndava të gjitha shoqëritë e Epirit të Veriut.... Të gjithë i dinë shpërblimet që i kanë bërë Epirotët e veriut hipotezës greke...»³¹

30 Abaz Dojaka, *Çamëria, Bota shqiptare, nr.3*, dhjetor 1992, 10.

31 *Po aty*, 7.

Se ç'kontribut kanë dhënë shqiptarët e Greqisë për çlirimin e saj dihet mirë nga historia e shekullit XIX, kështu që në mbledhjen e parë të Parlamentit të Greqisë sovrane, pika e parë e rendit të ditës ka qenë çështja e përdorimit të gjuhës në parlament, përkatësisht a të flitet shqip apo greqisht, duke marrë parasyshë numrin e deputetëve të këtyre dy kombësive. Diplomati dhe shkencëtari serb, Vlladan Gjorgjeviqi, edhe pse antishqiptar i verifikuar, shkruan në librin e tij «Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha»: «Më 1854, Mbretëria greke ka pasur vetëm 1 milion banorë; sipas të dhënave të konsulit Han, në atë milion 200 mijë kanë qenë shqiptarë. Autori i këtyre rreshtave (Dr. Vlladan Gjorgjeviqi - MK) ka jetuar më 1891 deri më 1983 në Atinë dhe me rastin e udhëtimeve të tij në rrethinat e ngushta të kryeqytetit të Greqisë, ka gjetur fshatra në të cilat banorët e tyre nuk dinin greqisht, por flasin dialektin gegë ose toskë. Këta ishin shqiptarë. Ata nga çdo aspekt ishin bërë qytetarë të mirë të Greqisë, por në shtëpi ata ende ishin shqiptarë.» Një shkencëtar tjetër serb, akademiku Jovan Cvijiqi, në vepren e tij të njohur «Gadishulli Ballkanik», duke folur për popullsinë e viseve të Egjeut dhe të Pindit, thotë: «Me rëndësi të madhe është procesi i helenizimit (greqizimit) të shqiptarëve të vendosur në Peloponez, Jeladë dhe Epir, i cili siç duket, ka filluar që nga shekulli XIV. Ky proces është zhvilluar në përmasa të konsiderueshme edhe te toskët në Shqipërinë e jugut. Sipas A.Philipsonit, edhe tash në Greqi, me kufij të para vitit 1912, janë 250 mijë shqiptarë, të cilët vetëm sipërfaqësisht janë greqizuar.»³² Kisha dhe propagande shtetërore greke i konsiderojnë për grekë të gjithë shqiptarët e fesë ortodokse edhe në Shqipëri, lere më në Greqi. Por në realitet edhe shumë familje të minoritetit grek në Shqipëri kanë prejardhje shqiptare, të ardhura nga Greqia, ku kanë filluar ta harrojnë gjuhën e tyre amtare shqipe. Politika asimilatore greko-ortodokse ka shtrirë dorën thellë në trojet etnike shqiptare, njësoj si shteti dhe kisha ortodokse serbe. Për ta arritur qëllimin e saj në këtë drejtim, kisha ortodokse mbështetet edhe në disa dokumente, diploma kishtare dhe shtetërore, për të përvetësuar fshatra, kisha dhe pasuri të tyre. Por një numër i mirë i diplomave të tilla janë falsifikate. I tillë është rasti, p.sh., me disa diploma të shekullit XIII e XIV në lidhje me manastirin e Shën Kollit në Vraninë në Liqenin e Shkodrës.³³ Kështu del se kisha ortodokse serbe i lejon vehtes çdo gjë, ajo nuk zgjedh mjete për t'ia arritur qëllimit, madje edhe atëherë kur qëllimi është shumë i pamoralshëm. Por duket se popat ortodoksë greko-

32 Jovan Cvijić, *Balkansko poluostrvo i južnoslovenske zemlje*, Beograd 1966, 141

33 S. Ćirković, *Albanci u ogledalu južnoslovenskih izvora, Iliri i Albanci, Srpska akademija nauka*, Beograd, 1988, 332.

serbë kanë peshojë të posaçme me të cilën e masin moralin e veprave të tyre.

Si përfundim të kësaj kumtese po rreshtoj këtu vetëm disa fjali. Dihet se historia është mësuese e jetës, por përvoja jetësore dëshmon se shqiptarët nuk kanë qenë gjithmonë nxënës të mirë të saj. Pra, na mbetet të mësojmë shumë, madje, edhe nga armiku.

Populli pa shtet është si njeriu pa shtëpi. Vetëdija e lartë kombëtare është themel mbi të cilin ndërtohet shteti. Kisha kombëtare mund të jetë shtyllë e fortë e shtetit sovran, por nëse nuk është e këtillë, ajo mund t'i rrezikojë themelet shtetërore.

Porosia e rilindësit tonë të madh shkodran Vaso Pashës duhet të jetë këngë djepi për fëmijët tanë, por edhe himn i rinisë dhe uratë e pleqërisë.

Benedikt Orsini, i emëruar ipeshkëv i Lezhës, i kombit të huaj, nuk u prit mirë në Shqipëri. Ai më 1621 i dërgon papës këtë ankesë të shkurtër: «Priftërinjtë shqiptarë kanë lidhur besë të mos pranojnë asnjë ipeshkëv që mos të ishte i kombit shqiptar.» Po të ishin gjallë këta besëlidhës bujarë, besoj se sot me plot të drejtë do të kërkonin që të mos pranohet asnjë klerik që nuk është me mish e me shpirt shqiptar. Pra, ta përmirësojmë notën, se jemi gjithënjë në provim para mësueses së jetës.

Mark Krasniqi

LE ROLE DE L'EGLISE ORTHODOXE SERBE ET GRECQUE DANS LEUR POLITIQUE ANTI-ALBANAISE

La Serbie et la Grèce ont exercé toujours une politique expansionniste et assimilatrice envers le peuple albanais et ont appuyé la politique anti-albanaise. Cette politique a été appliquée de différentes façons, mais principalement elle a utilisé la terreur et le génocide massif. L'église serbe a persécuté le clerc catholique, a usurpé les églises catholiques surtout à Kosovë et au Monténégro. Elle a obligé les Albanais de payer des taxes et de changer leurs prénoms en slaves et de se convertir. De la même manière, a agi l'église grecque qui a assimilé les Albanais orthodoxes. Au moyen âge, l'Etat serbe a interdit légalement la religion catholique, tandis que du temps de l'occupation osmanne l'église orthodoxe serbe avait réussi d'obtenir du Sultan des autorisations pour soumettre les Albanais catholiques.

En 1913 l'armée serbe et l'armée monténégrine avaient massacré 5000 Albanais de Kosovë, de Lumë, de Plavë et de Gusi et avaient obligé les Albanais d'accepter la religion orthodoxe.

Même de nos jours (1993) l'église serbe soutient la politique anti-albanaise, tandis que l'église grecque, elle aussi soutient la politique expansionniste de l'Etat grec envers l'Albanie, bien qu'une bonne partie du territoire albanais (Çameria) soit occupée depuis 1913.

